



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/773

Datë: 28 / 7 / 2023

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 22, paragrafit 1.5 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Kreun IV të Ligjit Nr. 03/L-212 të punës dhe Pjesën V të Ligjit Nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.7.2023, merr këtë:

**V E N D I M**

***për procedurën e trajtimit të kërkesave për lirim afatshkurtër nga paraqitja në punë të personelit dhe përgjegjësinë përkatëse disiplinore***

1. Në rastin e mungesës nga puna në periudha afatshkurtra, me qëllim të pjesëmarrjes në aktivitete nga të cilat mund të përfitojë UP (pjesëmarrje në hulumtime/veprimtari artistike, konferenca, simpoziume, vizita afatshkurtra, ofrim të ligjëratave/ushtrimeve në institucione partnere, pjesëmarrje në aktiviteteve të projekteve të përbashkëta, qëndrime në kuadër të punës profesionale e të ngjashme), personeli akademik duhet të ndjek procedurën si në vijim:
  - 1.1. Për lirimin nga paraqitja në punë deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, kërkesa me shkrim i parashtrohet dekanit të fakultetit. Në kërkesë përshkruhet arsyeshmëria dhe qëllimi i aktivitetit, mënyra e zëvendësimit të orëve mësimore dhe kryerjes së obligimeve tjera, nëse të njëjtat përputhen me ditët e mungesës në punë. Në rast të aprovimit të kërkesës nga dekani, personeli obligohet që pasi të kthehet në punë të dorëzojë te dekani raportin në të cilin përshkruhen aktivitetet e realizuara në periudhën e mungesës në punë. Në rastin e shefave të qendrave dhe koordinatorëve të zyrave në nivel të Universitetit, kërkohet pëlqimi paraprak i rektorit të Universitetit.
  - 1.2. Për lirimin nga paraqitja në punë mbi pesëmbëdhjetë (15) deri në tridhjetë (30) ditë, kërkesa me shkrim i parashtrohet dekanit të fakultetit. Në kërkesë përshkruhet arsyeshmëria dhe qëllimi i aktivitetit, mënyra e zëvendësimit të orëve mësimore dhe kryerjes së obligimeve tjera, nëse të njëjtat përputhen me ditët e mungesës në punë. Bazuar në kërkesën e parashtruar, shkresën mbështetëse të dekanit të fakultetit lidhur me arsyeshmërinë e kërkesës së tillë dhe mënyrën e zëvendësimit të orëve mësimore, Rektori merr vendimin përfundimtar.
  - 1.3. Për lirimin nga paraqitja në punë mbi tridhjetë (30) ditë, kërkesa me shkrim i parashtrohet dekanit të fakultetit. Bazuar në kërkesën e parashtruar, shkresën mbështetëse të dekanit të fakultetit lidhur me arsyeshmërinë e kërkesës dhe mënyrën e zëvendësimit të orëve mësimore, Këshilli drejtues merr vendimin përfundimtar. Nga kjo nën-pikë, përjashtohet lirimi për një vit të lirë të kërkimeve të fokusuara në një universitet të huaj, i cili rregullohet me dispozitë përkatëse të Statutit.
2. Në rastin e mungesave në punë për nevoja të realizimit të aktiviteteve në kuadër të projekteve Erasmus+, Horizon Europe e të ngjashme, nëse për pjesëmarrje në projekte të tilla paraprakisht është njoftuar Fakulteti, respektivisht sipas rastit është marrë pëlqimi paraprak nga instancat përgjegjëse në nivel të Fakultetit dhe të Universitetit, personeli akademik nuk ka nevojë të paraqes kërkesë për lirim nga puna, por duhet të njoftojnë me shkrim dekanin për periudhën e mungesës në punë, si dhe për mënyrën e zëvendësimit të orëve mësimore respektivisht kryerjen e obligimeve tjera nëse të njëjtat përputhen me ditët e mungesës në punë. Për arsyetimin e



mungesave në punë të personelit administrativ, me qëllim të pjesëmarrjes në aktivitetet e parapara në këtë pikë, sipas procedurës së njëjtë, njoftimi i adresohet sekretarit, e në mungesë të tij dekanit (në rastin e Fakultetit), respektivisht mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit, e në mungesë të tij sekretarit të përgjithshëm (në rastin e Universitetit).

3. Procedura e parashtrimit të kërkesës, gjegjësisht njoftimi me shkrim bëhen varësisht kategorisë së personelit dhe kohëzgjatjes së lirim afatshkurtër nga puna. Lirimi afatshkurtër në frymën e këtij vendimi konsiderohet i aprovuar vetëm nëse paraprakisht është bërë njoftimi respektivisht është aprovuar kërkesa përkatëse. Në të gjitha rastet personeli ka për obligim ta bëjë njoftimin, gjegjësisht të parashtrijë kërkesë për lirim afatshkurtër nga puna, së paku pesë (5) ditë më herët.
4. Përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi janë autoritetet përkatëse në nivel të Fakultetit dhe të Universitetit. Në rast të mungesës nga puna të personelit në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, eprori përkatës obligohet që lëndën pa vonesë ta procedojë për shqyrtim në Këshillin e etikës, përkatësisht në Komisionin disiplinor dhe atë si në vijim:
  - 4.1. Rektori i Universitetit për shifat e qendrave profesionale në nivel qendror;
  - 4.2. Sekretari i përgjithshëm i Universitetit për drejtorin e departamentit, gjegjësisht pozitën ekuivalente me të në Administratën Qendrore dhe në zyrat tjera në nivel të Universitetit;
  - 4.3. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, gjegjësisht menaxheri i linjës përkatëse për personelin e shërbimeve administrative në Administratën Qendrore dhe në zyrat tjera në nivel të Universitetit;
  - 4.4. Dekani i fakultetit për personelin akademik dhe sekretarin e fakultetit;
  - 4.5. Sekretari i fakultetit për personelin e shërbimeve administrative në fakultet.
5. Në rast të mosveprimit siç specifikohet në neni 4 të këtij vendimi, Këshilli Drejtues fton për raportim autoritetet përkatëse menaxhuese.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi me nr. prot. 995, datë 6.5.2022.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


### Arsyetim

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 27.7.2023, duke u bazuar në përgjegjësitë e tij të përcaktuara si në nenin 22, paragrafi 1.5 të Statutit të UP-së dhe përgjegjësinë e autoriteteve menaxhuese në sigurimin e kushteve të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të Universitetit në përputhje me obligimet e tij, ka marrë vendimin lidhur me procedurën e trajtimit të kërkesave të personelit për lirim afatshkurtër nga paraqitja në punë dhe përgjegjësinë përkatëse disiplinore.

Me qëllim të rritjes së përgjegjësisë dhe përmirësimit të vijueshmërisë në punë, në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe efikasitetit të shërbimeve që ofrohen në kuadër të Universitetit, në kuadër të zbatimit të legjislacionit të punës, legjislacionit për zyrtarët publikë dhe Statutit të UP-së, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### T'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Rektorit,
3. Prorektorëve,
4. Sekretarit të përgjithshëm,
5. Dekanëve të fakulteteve,
6. Sekretarëve të fakulteteve,
7. Drejtorëve të departamenteve.



Këshilli Drejtues i UP-së

Altin Sahiti, kryesues i KD-së